



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-38151/2021
Kaçanik, 29.12.2021

Në bazë të nenit 51 dhe 53 të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 3.2 lidhur me nenin 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 – për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 29 dhjetor 2021, mori këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

1. Me këtë Vendim formohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës Kaçanik nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe nga përfaqësues të komuniteteve.
2. Komiteti për Komunitete, është në përbërje, 5 anëtarë:

1. Lejla Muhaxheri –Çaka	PDK	anëtar
2. Arta Avdiu	LVV	anëtar
3. Betim Shala	LDK	anëtar
4. Ekrem Livoreka	AAK	anëtar
5. Arben Thaqi	OJQ/ Shoqëria civile	anëtar.
3. Detyrat e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.
4. Mbledhjet i kryeson Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve nga pika 2. e këtij vendimi. Në mungesë të Kryesuesit të Komitetit për Komunitete, mbledhjet i kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.
5. Kompensimi për punën e Komitetit për Komunitete rregullohet me vendim të veçantë sipas Udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Komunitete, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Makfire Malsiu

From: Besim Q. Ilazi
Sent: Wednesday, January 5, 2022 3:23 PM
To: Makfire Malsiu
Subject: FW: Propozim per K. Komunitete

-----Original Message-----

From: HandiKOS Kaçanik [mailto:handikoskaçanik@hotmail.com]
Sent: Wednesday, January 05, 2022 3:01 PM
To: Besim Q. Ilazi
Cc: Ylber Bajra
Subject: Propozim per K. Komunitete

Propozim për anëtar të Komitetit për Komunitete

I nderuar z. Besim Ilazi, Kryetar i Komunës Kaçanik.

Po ju shkruaj në lidhje me propozimin e një anëtarë nga shoqëria civile për anëtar të Komitetit për Komunitete.

Në komunën e Kaçanikut kemi shumë organizata joqeveritare të regjistruara me statute të ndryshme, mirëpo aktive kemi shumë pak andaj edhe ne përzgjedhje e patëm pak të vështire, disa organizata ishim pjesë e këtij komiteti në katër vitet e fundit e disa të tjera janë të angazhuara në KKSB, e komitete konsultative dhe nuk e pamë të arsyeshme ti propozojmë prapë.

Ne duke parë angazhimin e shoqatës së Pedagogëve të kulturës Fizike dhe duke ditur që kanë aktivitete direkt me rinin pame të arsyeshme të propozojmë z. Arben Thaqi, nga shoqata e pedagogëve të kulturës fizike si anëtarë potencial për të përfaqësuar shoqërinë civile në këtë komitet.

Me respekt

Elmihane Malsiu

Elmihane Malsiu

Drejtor në HandiKOS Kaçanik


Adresa: Bulevardi "Ismail Raka",

Pallati i Kulturës nr 200.

Tel +383 44 235 717

#VAKSINOHU

[<https://mpb.rks-gov.net/Uploads/EditorFiles/TextHtml/82/vaksinimi.png>]



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Zyrtaret përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës 01 Nr. 60/01-38131/21 për formimin e Komitetit për Komunitete
I miratuar më datë: 29.12.2021
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.01.2022

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.